



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:007922

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05564094

C.nr.1219/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. J. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Shëndetësisë në Kamenicë, me objekt kontesti, padi për pagesën e pagës jubilarë si dhe shpërblimin e pagës së trembëdhjetë, me vlerë të kontestit prej 725.00 €, jashtë seancës, më datën 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkespacia e paditëses M. J. nga dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Shëndetësisë në Kamenicë, që paditëses, t’ia paguajë vlerën e një page bazë në shumë prej 362.50 euro, në emër të pagës së trembëdhjetë për punën e bërë gjatë vitit 2020, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data 28.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, edhe atë shuma prej 362.50 euro në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, **REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj paditësit shumën prej 134.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datën 28.12.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagës së trembëdhjetë me vlerë të kontestit prej 1,508.00 €. Në padi paditësi ka theksuar se është në marrëdhënie pune te e paditura. Kërkesën e tij paditësi e ka bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (më tej: KKS), konkretisht në nenin 17 pargarfi 3, duke theksuar se “**Punëmarrësi ka të drejtë**

në kompensimin e shpërblimit jubilar për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit". Meqenëse e paditura nuk i ka paguar vullnetarisht mjetet të cilat ka qenë e obliguar t'i paguaj, paditësi kërkon nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkespadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura t'ia paguaj shumën prej 1,508.00 me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së kësaj padisë. Gjithashtu e njëjta i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar kërkespadinë duke theksuar se kemi të bëjmë me skadim të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e cila ka paraparë kompensimin e pagës së 13-të sipas mundësive buxhetore, kurse nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe faktet vendimtare, se paditësi është në mardhënie të punës tek e paditura, se ka pagën bazë në lartësi prej 377.00 € dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale në nenin 17, pika 3 e saj, e ka rregulluar këtë materie, duke cituar dispozitat ligjore sa i përket shpërblimit të pagave jubilarë për vitet e punës.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare si dhe nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë, përveç që është thirrur në skadim, dhe në mungesë të mjeteve buxhetore ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara, konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura (fakt i provuar edhe nga Kontrata e Punës me nr. 08-230 të datës 11.06.2015 për paditësin, paga bazë e të njejtit është 377.00 euro, (fakt i provuar nga lista e pagës në emër të paditësit).

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësit është në mardhënie të punës tek e paditura, dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale me nr. 05-3815 e datës 12.06.2018 në nenin 17, pika 2 i saj, e ka rregulluar këtë materie, pasi që në nenin përkatës shprehimisht është përcaktuar se *“Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kemi skadim të Kontratës Sektoriale për Shëndetësi, për gjykatën një pretendimi i tillë nuk qëndron, pasi që padia në gjykatë është parashtruar me dt. 20.11.2023 kurse Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka hyrë në fuqi me dt.11.06.2018, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi padinë e ka ushtruar brenda afatit ligjor prej tre /3/ viteve, pasi që sipas nenit 87 të Ligjit të Punës,/ *Ligji nr. 03/L-212 date 01.12.2010/*, në mënyrë shprehimore është paraparë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Ndërsa sa i përket kërkesës për shpërblimin jubilar në shumë prej 1,131.00 euro, gjykata e refuzoi në tërësi si të pa bazuar, mëqë duke u bazuar në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me numër 40/2023, të datës 27.02.2023, edhe atë në pjesën e dytë, pika IX, theksohet se punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2021, janë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet më nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte, edhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore të punëdhënësi i fundit, e nga ky fakt gjykata erdhi në përfundim se paditësja nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensimin në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, për faktin se Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2021, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018, deri më datën 10.06.2021, e nga ky fakt gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ *Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/*.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë
C.nr.874/2023, dt.26.02.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:007922
Datë: 11.04.2024
Numri i dokumentit: 05564094